



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA E SHERBIMEVE QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sn. 02 Nr. 33538
U. Br.
Nr. i faq. 3 Data: 21/10
Bz. str. KAMENICA 2024

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III-te e Komitetit per Zhvillim Ekonomik

Mbledhja u mbajt ne restaurantin Joni Ranch me datë 12.09.2024 dhe filloi nga ora 17:00. Në mbledhje ishte e pranishme edhe drejtoresha.

Mbledhjen e -III-rë (të rregullt) të Komitetit për Zhvillim Ekonomik e cila do të mbahet ditën e Enjte me datë: 12.09.2024, duke filluar nga ora 17:00.

Mbledhjen e hapi kryesuesja e Komitetit per Zhvillim Ekonomik, Albana Ajvazi.

Albana Ajvazi: Për mbledhje propozoj këtë rend dite:

REND DITE

1. Shqyrtimi I procesverbalit te mbledhjes se kaluar
2. Plani buxhetor, plani vjetor I investimeve kapitale dhe progresi ne realizimin e strategjise zhvillimore;
3. Masat stimuluese te qytetit\komunes per ekonomine\bujqesine dhe punesimin;
4. Tarifat dhe taksat administrative dhe komunale, ne fazen e planifikimit;
5. Dokumentacioni I planifikimit hapasinor (planet urbanistike lidhur me zonat afariste\industriale);
6. Cmimet dhe cilesia e sherbimeve komunale;

7. Mbrojtjen e mjedisit dhe mundesite per nje ekonomi te gjelber;

Albana Ajvazi: Pershendetje per te gjithë! Faleminderit qe keni gjete kohe per te marre pjese ne kete mbledhje. Mbledhjen e kaluar kemi diskutuar me shume per planin e punes se ketij komiteti dhe se si asamblesitet mund ti qojne perpara kerkesat e bizneseve.

Drejtoresha Burbuqe: Pershendetje per te gjithë. Kemi me bo planifikimin e buxhetit. Gjendja e investimev kapitale 2 528 000 Euro, subvencione - 385 000 Euro.

Qdo nevojë qe keni, qdo kerkese, anetaret e kuvendit do ti adresojne. Te qeshtjet e subvencioneve nese keni ndonje propozim, urdheroni.

Qamil Fetiu: Cilat jane kriteret per aplikim per subvencion?

Drejtoresha: Po ka kriteret, dhe ato jane bere ne baze te rregullores.

Labinot Skoverqani: A ju ndalohet dikujt aplikimi per subvencione?

Drejtoresha Burbuqe : Po ju ndalohet.

Fatmir: Kamenica permes investimev po behet me e bukur, A mundet ky qytet mu gjallëru me rini. Komuna po e perdor planin e njejt sikur te qeverive te kalume.

Drejtoresha Burbuqe: Drejtorit e planifikojne buxhetin per vitin 2025, qka mundet Drejtoria e Zhvillimit Ekonmik me bo dhe me ofru per bizneset. Jemi qdo here e me shume tu kerku fonde.

Labinot Skoverqani: A osht bo naj ndryshim per tarifat dhe taksat?

Drejtoresha Burbuqe: Jo nuk osht bo.

Labinot Skoverqani: Ketu hyn edhe bizneset qe mbyllen te dieleve.

Drejtoresha: Mundemi me disku si qeshtje.

Labinot Skoverqani: Qka ndodh nese bizneset marrin punetor ekstra per mi mbajt bizneset te dieleve?

Drejtoresha: Kerkesa ka qene prej vet biznesev, ne si drejtori nuk mundemi me bo ndonje gje.

Fatmir: Ma mire me qene bizneset hap, sepse po perfitojne bizneset jasht kamenices, e keto bizneset ne Kamenice sidomos ato te voglat po humbin shume.

Basri: Pajtona edhe une me Fatmirin, duhet komuna me bo ndonje plan ne menyre qe te rinjte te mos te dalin jashte shtetit, me I ndihmu me shume, gjithashtu propozoj qe te rriten shtesat per lindje te femijeve.

Te shtrohet rruge prej Rogoqices deri ne Kamenice.

Labinot Skoverqani: Ajo pjese e Kamenices ka mbet pa u lidhur me kamenicen dhe kish ndiku shume ne bizneset ne rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Muhamedi: Kep ka lyp prej komunes te bashkpunoj me bizneset, komunes I ndihmojm tu punsu njerz, na jem si sponzor.

Ladi: Propozoj me ja nis me prodhu video dhe me shpernda dhe me publiku video te pamjev te bukura te natyre se Kamenices se paku qdo jave, pasi kur ta shohin njerezit, te mendojne dhe planifikojne te ndertojn dhe zhvillojne biznese, te kete promovime te tilla sa me te medha per turizem. Ky propozim nuk kerkon shume fonde.

Drejtoresha Burbuqe: Komuna ka me bo adaptimin e objeketv per bujtina malore.

Ladi: Kemi bisedu me shoqaten fondacioni Green, me bo ni llojn brendimi per produktet psh mjalten.

Albana Ajvazi: Nese nuk keni diqka tjeter per te shtuar, e mbylлим kete mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit



Albana Ajvazi